

VENDIM
Nr. 13, datë 22.4.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.305, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS FINANCIARE PËR TË PUNËSUARIT AKTUALË DHE PUNONJËSIT E LARGUAR NGA PUNA SI PASOJË E COVID-19”

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe të vendimit nr.305, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e COVID-19”, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, në zbatim të masave të marra pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore, i mbledhur sot më 22.4.2020,

VENDOSI:

1. Propozimin Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:
 - Dhënien e ndihmës financiare prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh për punonjësit e Rafinerisë së Naftës, Ballsh, të cilët figurojnë në listëpagesën e muajit dhjetor 2019 dhe që kanë një pagë bruto nën masën 100 000 (njëqind mijë) lekë/muaj.
 - Dhënien e ndihmës financiare prej 16 000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh për aplikuesit e ndihmës ekonomike, të cilët rezultojnë aplikues që nga muaji korrik 2019 e deri në muajin prill 2020, të cilët nuk kanë përfituar ndihmë ekonomike dhe, aktualisht, nuk përfitojnë as nga fondi 6 për qind akorduar bashkive, përveç rasteve që janë përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike, sipas nenit 15, të ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.
2. Ngarkohet ministri i Shtetit për Rindërtimin për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINTOR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama